



www.d4d-ks.org

Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Përtej barazisë numerike

*Fuqizimi i grave anëtare të Kuvendeve
të Komunave në qeverisje lokale*



Prishtina, Korrik 2020

Përtej barazisë numerike

Fuqizimi i grave anëtare të Kuvendeve të Komunave në
qeverisje lokale

Copyright © 2017. Demokraci për Zhvillim (D4D)

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimit të pasazheve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rrikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Përgatitur nga: Dita Dobranja

“Ky hulumtim u mundësua nga Programi Angazhimi për Barazi - E4E, i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID dhe i përkrahur nga Qendra për Burime dhe Trajnime për Avokim - ATRC”

“Përmbajtja e këtij hulumtimi është përgjegjësi e Institutit Demokracia për Zhvillim (D4D) dhe nuk paraqet ose pasqyron qëndrimet ose opinionet e Qeverisë së SHBA-së ose të USAID-it”

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	5
Hyrje	7
Metodologjia	9
Hulumtimi dokumentar	9
Analiza e të dhënave parësore	10
Analiza legjislative	11
Kushtetuta e Republikës së Kosovës	11
Ligji për Barazi Gjinore	12
Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi	12
Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligji për Zgjedhjet Lokale	13
Ligjet dhe dokumentet e tjera	13
Analiza dokumentare	14
Rezultatet e anketës	15
Rezultatet e përgjithshme	16
Përfaqësimi i grave në nivelin lokal	17
Puna aktive e grave në nivelin lokal	18
Mungesa e projekteve dhe e investimeve të ndjeshme nga aspekti gjinor	19
Pengesat dhe sfidat për gratë anëtare të kuvendeve komunale	21
Ndërtimi i kapaciteteve dhe fushat për përmirësim	25
Përfundimet dhe rekomandimet	30
Referencat	33
Shtojca 1: Pyetëtori	34
Shtojca 2: Lista e dokumenteve të konsultuara	37

Përmbledhje ekzekutive

Me këtë raport synojmë të paraqesim një analizë të rolit dhe sfidave të grave anëtare të kuvendeve lokale në pesë komuna të përzgjedhura në Kosovë. Duke përdorur hulumtimin dokumentar, e më saktësisht analizën e procesverbaleve të mbledhjeve të kuvendeve komunale, si dhe hulumtimin parësor të realizuar me gratë përfaqësuese të kuvendeve komunale në Prishtinë, Kamenicë, Istog, Mitrovicë dhe Prizren, në raport vlerësohet situata aktuale e përfaqësimit të grave në këto komuna, përtej numrave. Ndonëse përfaqësimi i grave në kuvendet komunale garantohet nga kuota 30 përqind, pjesëmarrja e tyre aktive dhe kontributi i tyre nuk është i garantuar dhe shpesh dështon. Kjo kryesisht për shkak të sfidave dhe pengesave me të cilat përballen gratë anëtare të kuvendeve komunale. Në këtë raport analizohen këto sfida dhe pengesa siç identifikohen nga vetë gratë anëtare të kuvendeve komunale, ndërsa njëkohësisht vlerësohen edhe fushat e mundshme të ndërhyrjes që mund t'i zvogëlojnë këto pengesa.

Raporti shërben si bazë për zhvillimin e mëtutjeshëm të projektit, duke siguruar udhëzime për zhvillimin e moduleve të trajnimit dhe ndërtimin e kapaciteteve, ndërhyrjet e mundshme të politikave, si dhe fushat e përmirësimit që do të merren në konsideratë në të ardhmen.

Nga analiza e dokumenteve ekzistuese për punën e kuvendeve komunale, veçanërisht duke u përqendruar në procesverbalet e mbledhjeve dhe procesverbalet e takimeve, gratë anëtare të kuvendeve janë më pak të angazhuara në diskutime dhe veçanërisht më pak të angazhuara në shtyrjen përpara të politikave dhe të ideve të projektit në mbledhjet e kuvendeve komunale. Ky konstatim mbetet i njëjtë në të gjitha komunat dhe partitë politike. Duke qenë se kjo analizë bazohet në transkripte dhe dokumente, ajo është gjithëpërfshirëse, pra, përfaqëson të gjitha partitë politike. Nga ana tjetër, në anketë ka një përfaqësim më të lartë të partive më të mëdha, përkatësisht LDK, me 32 përqind e të anketuarve, PDK, me 27 përqind të të anketuarve, 14 përqind nga të dyja, AAK dhe Vetëvendosje, dhe 9

përqindëshi i mbetur nga PSD dhe 5 përqind nga NISMA. Ky përfaqësim është në përputhje me përbërjen e partive politike të kuvendeve komunale në komunat përkatëse. Sidoqoftë, duke pasur parasysh që të anketuarit nga Prizreni kanë pasur një shkallë më të lartë të reagimit, krahasuar me më të ulëtën në Prishtinë, rezultatet në raport janë paraqitur në përgjithësi, por edhe të ndara sipas komunës, për të ofruar njohuri më specifike. Në terma të përgjithshëm, megjithëse shumica e grave pajtohen se niveli i përfaqësimit të grave në komunën e tyre është i kënaqshëm, akoma më shumë se 30 përqind e grave besojnë se përfaqësimi i tyre në nivelin lokal është ose në nivel jo të kënaqshëm ose në nivel jo të dëshirueshëm. Ky përfundim tregon se përkundër zbatimit të kuotës gjinore, gratë anëtare të kuvendeve komunale konsiderojnë se të qenit pjesë e kuvendeve në vetvete nuk është përfaqësuese.

Për më tepër, kjo është e dukshme kur vlerësohen pengesat me të cilat përballen gratë anëtare të kuvendeve komunale gjatë mandateve të tyre. Çështjet sillen që nga mungesa e mundësive për avokim dhe për ndryshim të politikave, e deri te çështjet që lidhen me mungesën e linjave buxhetore për projekte që kanë për synim fuqizimin e grave anëtare të kuvendit komunal, ose fuqizimin e grave në komunat e tyre përkatëse.

Rëndësia e vendosur në pjesëmarrjen thelbësore theksohet më tej përmes gatishmërisë së grave anëtare të kuvendeve komunale për të marrë pjesë në ndërtimin e kapaciteteve dhe në trajnime, edhe pse mundësi të tilla u ofrohen vetëm rreth 50 përqind të të anketuarve nga partitë e tyre përkatëse. Trajnimet për të cilat gratë anëtare të kuvendeve komunale kanë treguar shkallën më të lartë të interesimit janë fuqizimi ekonomik i grave, barazia gjinore, roli i qeverisjes lokale dhe kuvendit komunal dhe trajnimet e përgjithshme.

Për më tepër, dy nga tri gratë anëtare të kuvendeve komunale besojnë se investimet dhe projektet që komuna e tyre i realizon nuk e përfshijnë gjininë. Në shembuj të tillë hyjnë mungesa e investimeve në infrastrukturën e përkujdesjes ndaj fëmijëve, mungesa e grave në pozitat vendim-marrëse, si dhe mungesë e përgjithshme e objektivit ndaj nevojave gjinore në buxhetimin dhe planifikimin e investimeve.

Hyrje

Pjesëmarrja politike e grave në Kosovë ka qenë temë e diskutimeve dhe e analizave që në masë të madhe janë përqendruar në përfaqësimin e nivelit qendror. Si Republikë e re, Kosova ka adoptuar konventat dhe rregulloret ndërkombëtare ekzistuese me të cilat Kosova zotohet se do të sigurojë pjesëmarrje aktive të grave në jetën publike, politike dhe në institucione të nivelit qendror dhe atij lokal. Megjithëse nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara, Kushtetuta e Kosovës përfshin zbatueshmërinë e disa marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare që sigurojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe luftën kundër diskriminimit. Sa i përket barazisë gjinore, Kushtetuta parasheh zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) me të cilën ndër të tjera u bëhet thirrje shteteve nënshkruese që t'u sigurojë grave dhe burrave të drejta të barabarta për të pasur të drejtë për poste publike dhe t'i mbajnë ato poste publike.¹ Kosova, ndonëse nuk është nënshkruese e kësaj Konvente (CEDAW) e ka përfshirë atë në nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës, ku përfshihen të gjitha instrumentet e tjera ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut, duke qenë kështu të zbatueshme drejtpërdrejt sipas Kushtetutës. Përveç kësaj, Kosova ka miratuar edhe plane veprimi të përcaktuara nga organizata ndërkombëtare që synojnë të rrisin rolin e grave në poste publike, siç është Plani i Veprimit në zbatim të Rezolutës 1325² të KSKB-ve, “Gratë, Paqja dhe Siguria”. Kështu pra, Kosova e njeh dhe e pranon rëndësinë e përfshirjes dhe të fuqizimit të grave në jetën publike, veçanërisht në postet publike. Ky zotim për pjesëmarrjen aktive të grave në jetën publike dhe politike shihet në Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale.

1 Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Nju Jork, 18 dhjetor 1979, i qasshëm në: https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/CEDA*.aspx

2 Plani Kombëtar i Veprimit mbi Paqën dhe Gratë, i qasshëm në: <https://www.peacewomen.org/nap-kosovo>

Në përgjithësi, studimet tregojnë se rritja e pjesëmarrjes politike të grave rezulton në vendime të përmirësuara mbi politikat, veçanërisht vendime që lidhen me përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe adresimin e nevojave të tyre.³ Një shembull është Mbretëria e Bashkuar, ku studimet tregojnë se ndikimi i grave deputete gjatë gjithë historisë është i rëndësishëm në adresimin, jo vetëm çështjeve që lidhen me gratë drejtpërdrejt, por edhe me ngritjen e çështjeve mbi politikat familjare, arsimin dhe kujdesin.⁴ Shembuj të tjerë tregojnë se rritja e përfaqësimit të grave në parlamente, si në Greqi, Portugali dhe Zvicër, rezultuan me investime më të larta në arsim, ndërsa rënia e numrit të grave anëtare të parlamentit në Irlandë, Itali dhe Norvegji gjatë viteve 1990, i uli shpenzimet kombëtare në arsim.⁵ Këto shifra tregojnë se vetëm pjesëmarrja e grave sjell rezultate të përmirësuara në politika që ndikojnë në jetën e qytetarëve; megjithatë, pjesëmarrja aktive e grave e bën ndryshimin në fokusimin në politika dhe veprime që kanë një ndikim të tillë.

Ndonëse në Kosovë, gratë përbëjnë 30% të legjislaturës, si në nivelin lokal, ashtu edhe në atë qendror, pjesëmarrja e tyre aktive, veçanërisht në nivelin lokal, mbetet problem. Ky studim shqyrton rolin e grave në kuvendet komunale të pesë komunave të përzgjedhura në Kosovë: Prishtinë, Kamenicë, Istog, Mitrovicë dhe Prizren. Studimi është i organizuar si më poshtë: kapitulli i parë shqyrton qasjen metodologjike të analizës, duke siguruar pasqyrën e instrumenteve të përdorura dhe rëndësinë e tyre për rezultatet e paraqitura. Kapitulli i dytë jep një përmbledhje të legjislacionit që rregullon pjesëmarrjen e grave në postet publike dhe në legjislaturë në Kosovë. Kapitulli i tretë përfshin një analizë të dokumenteve të të procesverbaleve që janë në dispozicion të publikut mbi punën e këtyre pesë komunave. Kapitulli i katërt paraqet gjetjet nga anketa me gratë anëtare aktuale të kuvendeve komunale. Kapitulli i fundit, i pesti, ofron konkluzionet e rezultateve dhe jep rekomandime për hulumtime të mëtejshme dhe ndryshime në politika.

3 A. Cammisa, and B. Reingold, "Women in State Legislatures and State Legislative Research: Beyond Sameness and Difference," *State Politics and Policy Quarterly* Vol. 4, No.2 (2004): 181-210, <http://www.jstor.org/stable/40421515>.

4 Caroline Criado Perez, "Invisible Women," 2019.

5 Po aty.

Metodologjia

Kjo pjesë ofron një përshkrim të përgjithshëm të qasjes metodologjike të përdorur në këtë analizë. Për të siguruar një analizë të rolit të grave në ushtrimin e ndikimit sa i përket krijimit të politikave në nivelin lokal, me synimin specifik tek gratë anëtare të kuvendit në qeverisjen lokale, ky studim përdor metoda të përziera të mbledhjes dhe analizës së të dhënave.

Së pari, përmes hulumtimit dokumentar, është bërë një analizë e dokumenteve ekzistuese dhe e procesverbaleve të mbledhjeve dhe e vendimeve të kuvendeve komunale për komunat e përzgjedhura: Prishtinë, Kamenicë, Istogu, Mitrovicë dhe Prizren. Së dyti, studimi përdor të dhëna të drejtpërdrejta të mbledhura përmes një studimi me gratë anëtare të kuvendeve komunale në këto pesë komuna. Për më tepër, studimi gjithashtu përdor shqyrtimin e literaturës dhe analizën krahasuese të të dhënave cilësore si kombinim i teknikave të hulumtimit për të siguruar rezultatet më të gjithanshme të hulumtimit.

Hulumtimi dokumentar

Analiza e dokumenteve e realizuar përmes hulumtimit dokumentar paraqet bazën për të treguar pjesëmarrjen e grave në kuvendet komunale jo vetëm në aspektin numrave, por edhe sa i përket përmbajtjes. Analiza e dokumenteve është bërë për dokumentet që janë në dispozicion të publikut për komunat e përzgjedhura. Për shumicën e komunave, dokumentet në dispozicion të publikut janë që nga vitet 2011 dhe 2012 për të gjitha komunat, që ofrojnë të dhëna për tre kuvende komunale të njëpasnjëshme.



Analiza e të dhënave parësore

Për nevojat e këtij studimi, të dhënat kryesore u mblodhën duke përdorur anketën me gratë anëtare të kuvendeve komunale në pesë komunat e përzgjedhura. Pas përcaktimit të mostrës, hapi i radhës ishte hartimi i pyetësorit bazuar në analizën paraprake të dokumenteve dhe të literaturës.

Anketa u ishte shpërndarë grave anëtare të kuvendeve komunale në internet, duke i targetuar ato direkt përmes postës elektronike të tyre (e-mail). Mostra u ndërtua ashtu që t'i përfshinte të gjithë anëtare gra të kuvendeve, kështu që ishte një studim i targetuar i përgjithshëm i popullatës; megjithatë shkalla e përgjigjes përfundimtare u regjistrua në 35 përqind nga anketa online. Nga gjithsej 66 anëtare në pesë komunat e targetuara, 23 ofruan reagimet e tyre në anketë direkt përmes anketës online. Ndërsa 6 të tjera ofruan reagimet e tyre përmes intervistave telefonike, duke arritur në 45 përqind të të anketuarve të targetuar.

Pyetëtori, i paraqitur në Shtojcën 1: Pyetëtori përmban pyetje të përgjithshme lidhur me profilin e grave anëtare të kuvendeve komunale, më konkretisht pyetje për komunën në të cilën ato shërbejnë, partinë politike të cilës ato i përkasin, arsimin dhe mandatin e tyre si anëtare të kuvendit komunal. Pjesa kryesore e pyetësorit konsiston në pyetjet që synojnë marrjen e informacionit (sasiore dhe cilësor) për rolin e grave në vendim-marrjen lokale, perceptimin e grave anëtare të kuvendeve komunale për rolin dhe rëndësinë e angazhimit, si dhe mënyra në të cilat të anketuarat e konsiderojnë se ato mund të përmirësohen, si në aspektin e angazhimit, ashtu edhe të përmbajtjes.

Të dhënat e mbledhura u koduan dhe u analizuan duke përdorur softuerin e analizës statistikore, STATA dhe Excel. Duke pasur parasysh që anketa ishte ndërtuar për të siguruar të dhëna sasiore dhe cilësore, analiza e të gjitha rezultateve u kontrollua në mënyrë të verifikueshme. Analizat e të dhënave në këtë studim bazohen në statistikat përshkruese dhe disa analiza të tabelave të kryqëzuara. Po ashtu, u konsultuan studime dhe raporte përkatëse nga palë të treta për t'i validuar gjetjet.

Analiza legislative

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës bazohet në parime që i garantojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, si brenda të drejtës së vet, por edhe ashtu siç parashihet dhe garantohet nga marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare. Neni 22 i Kushtetutës, siguron zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare që garantojnë respektimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë zbatueshmërinë e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).⁶ Për më tepër, Kushtetuta e Kosovës e konsideron barazinë gjinore si “vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.” Nga kjo, kërkesat specifike të Kushtetutës janë që Kuvendi i Kosovës, Gjykata Kushtetuese, shërbimi civil, prokuroria dhe gjyqësori, të gjitha janë të bazuara në respektimin e barazisë gjinore dhe parimeve ndërkombëtare.

Për më tepër, Kushtetuta e përcakton qartë që ndalon çdo lloj forme të diskriminimit, përfshirë këtu diskriminimin gjinor.

6. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22, e qasshme në:
<http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

7. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 7, paragrafi 2, e qasshme në:
<http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>



Ligji për Barazi Gjinore

Qëllimi i Ligjit të Kosovës për Barazi Gjinore është të “garantojë, mbrojë dhe promovojë barazinë midis gjinive si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë.”⁸ Për më tepër, ligji synon të sigurojë mundësi të barabarta si për gratë, ashtu edhe për burrat në pjesëmarrje dhe kontribut në fushat e jetës, politike, socio-ekonomike dhe kulturore. Ligji parashikon gjithashtu masa pozitive dhe kuota që duhet të zbatohen për të siguruar pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave, nëse pjesëmarrja është e pabarabartë. Përfaqësim i pabarabartë, sipas ligjit, konsiderohet çdo përfaqësim i grave ose burrave që nuk pasqyron përfaqësimin e përgjithshëm në popullatë. Më konkretisht, ligji përcakton që përfaqësimi i barabartë në të gjitha organet arrihet kur “sigurohet një përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë në organet e tyre drejtuese dhe vendim-marrëse.”⁹ Ligji parashikon gjithashtu mekanizma monitorimi, si në nivelin qendror, përmes Agjencisë për Barazi Gjinore, dhe në nivelin lokal përmes zyrave të përcaktuara dhe zyrtarëve që sigurojnë zbatimin e ligjit dhe parimet e barazisë gjinore.

Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon të gjitha format e diskriminimit në shoqëri, përfshirë diskriminimin gjinor.¹⁰ Në ligj detajohet që format e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të diskriminimit janë të ndaluara me ligj dhe u nënshtrohen veprimeve juridike. Për më tepër, ligji parashikon masa pozitive për grupet që janë me nën-përfaqësim ose të pavlerësuar në institucionet ekzistuese.

8. Ligji për Barazi Gjinore, 2015, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>

9. Po aty.

10. Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, 2015, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10924>

11. Law on General Elections, 2008, accessed at: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligji për Zgjedhjet Lokale

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, bazuar në dispozitat e Kushtetutës së Kosovës, siguron përfaqësimin e grave në Kuvendin e Kosovës. Ligji kërkon që të gjitha subjektet politike të kenë të paktën 30 përqind kandidatë meshkuj dhe të paktën 30 përqind kandidatë femra në listat e tyre, me një kandidat të secilës gjini të përfshihet të paktën një herë në një grup prej tre kandidatësh. Për më tepër, ligji kërkon që “të gjitha subjektet politike dhe organet zgjedhore janë të obliguara të respektojnë kërkesat e kuotës gjinore të përcaktuara me këtë ligj.” Sidoqoftë, ka pasur diskutime si për Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, ashtu edhe për Ligjin për Zgjedhjet Lokale që një kuotë prej 30 përqind nuk është në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore, i cili përcakton një përfaqësim 50 përqind të grave dhe burrave njësoj. Ligji për Zgjedhjet Lokale, bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjin për zgjedhjet e përgjithshme, mban një kuotë gjinore prej 30 përqind për përfaqësim politik në kuvendet komunale.

Ligjet dhe dokumentet e tjera

Përveçkëtyre, Kosova ka një kornizë të pasur ligjore dhe një kornizë të miratimit të marrëveshjeve ndërkombëtare që synojnë të luftojnë diskriminimin gjinor dhe të sigurojnë barazinë, përfshirë Ligjin për Shërbimin Civil, mekanizmat institucionalë për të promovuar dhe siguruar barazinë gjinore, zotimin për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal, etj. Për më tepër, sa i përket postit publik dhe kandidimit për poste publike, Kosova e rregullon financimin e partive politike përmes Ligjit për Financimin e Partive Politike, i cili, ndër të tjera, parashikon që 10 përqind e fondeve që merr secila parti nga Kuvendi i Kosovës, të kanalizohet drejt mbështetjes së punës së secilit deputet të Kuvendit. Kjo dispozitë synon të sigurojë investime të barabarta në anëtarët e parlamentit nga secila parti; megjithatë, ligji nuk arrin të sigurojë që një ndarje e tillë të kërkohej edhe nga 90 përqind e financimit të mbetur.

11. Law on General Elections, 2008, accessed at: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

12. Law on the Financing of Political Parties 2013, accessed at: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8866>

Analiza dokumentare

Analiza e dokumenteve ekzistuese, e procesverbaleve të mbledhjeve dhe e vendimeve të kuvendeve komunale për komunat e përzgjedhura: Prishtinë, Kamenicë, Istogu, Mitrovicë dhe Prizren, tregon që gratë anëtare të kuvendeve tregojnë një angazhim më të ulët në diskutime gjatë mbledhjeve. Përfshirja e tyre, si për nga vëllimi, ashtu edhe për sa i përket përmbajtjes, mbetet pas homologëve të tyre meshkuj.

Bazuar në analizën e procesverbaleve të punës të kuvendeve komunale në këto komuna, gratë anëtare të kuvendit për sa i përket pjesëmarrjes në diskutim gjatë takimeve të rregullta të kuvendeve komunale, janë të angazhuar më pak se homologët e tyre burra. Në dy mandatet e kaluara të kuvendeve komunale, gratë anëtare të kuvendeve përfaqësojnë më së shumti 40 përqind të diskutuesve në mbledhjet e kuvendeve komunale, dhe kjo ka ndodhur në komunën e Prishtinës, ku gjashtë gra anëtare të kuvendit komunal janë angazhuar në diskutime gjatë një mbledhje të rregullt në gusht të vitit 2018.¹³Ky nivel i pjesëmarrjes ndryshon nga një përqindje e ulët prej 8 përqind e diskutuesve në takime të caktuara në komunën e Kamenicës, ku gjatë një mbledhje të rregullt, më 10 prill 2018, tre gra anëtare të kuvendit kanë folur vetëm pesë herë.

Analiza e fjalimeve dhe e debateve gjatë mbledhjeve të kuvendeve komunale, më tej tregon se pjesëmarrja substanciale e grave drejtohet më shumë në tema që përfshijnë arsimin, shëndetësinë, kulturën, dhe diskutimet e çështjeve specifike me të cilat ballafaqohen qytetarët në jetën e tyre të përditshme (siç janë kanalizimet dhe trajtimi i ujit në pjesë të caktuara të komunës). Anëtarët gra të kuvendit komunal në komunat që janë hulumtuar kanë dy herë më shumë gjasa të përfshihen në debat dhe të propozojnë ndryshime kur tema e diskutimit lidhet më direkt me qytetarët. Për më tepër, gratë anëtare të kuvendeve komunale të komunave kanë më pak të ngjarë të përfshihen në debate kur diskutimi përfshin çështje që lidhen me financimin, veçanërisht kur çështja që diskutohet ka të bëjë me investimet kapitale dhe projektet e komunës. Sidoqoftë, edhe në rastet kur gratë anëtare të kuvendit komunal janë përfshirë në këto debate, bazuar në të dhënat e mbledhjeve, pozicionet dhe argumentet e tyre nuk janë marrë parasysh.




13. Takimi i rregullt i Kuvendit Komunal të Prishtinës i mbajtur më 06/08/2018 i qasshëm në: <https://kk.rks-gov.net/prishtine/category/procesverbalet/>

Rezultatet e anketës

Kjo pjesë ofron një përshkrim dhe analizë të rezultateve sasiore dhe cilësore të anketës së realizuar me gratë anëtare të kuvendeve komunale në komunat: Prishtinë, Kamenicë, Istog, Mitrovicë dhe Prizren. Nga 66 gra, që përfaqësojnë të gjitha partitë kryesore në Kosovë (Vetëvendosje, LDK, PDK, AAK, NISMA, PSD, Lista Serbe, KDTP) që janë anëtare të kuvendeve komunale në këto komuna, 31 përqind prej tyre morën pjesë në anketim, me pjesëmarrjen që shkon prej 22 përqind në Istog në rreth 40 përqind në Prizren. Ndarja partiake e të anketuarve është treguar në Figurën 1.

Figura 1 Përfaqësimi partiak i të anketuarave



Një e treta e të anketuarve kërkuan të mbeten anonime, ndërsa pjesa tjetër i ofruan të dhënat e tyre të identifikimit. Përfaqësimi i partive politike mbetet i përzier, të gjitha partitë janë të përfaqësuara në total, por jo të gjitha partitë përfaqësohen në nivelin komunal.

Rezultatet e përgjithshme

Gjeografikisht, të anketuarit janë përhapur në pesë komunat e përzgjedhura në tërë Kosovën. Shkalla më e lartë e reagimit ka qenë në komunën e Prizrenit, ndërsa më e ulëta në Prishtinë. Shkalla e përgjigjes ka qenë rreth 30 përqind në përgjithësi për të gjitha komunat e tjera.

Sa i përket arsimit, rreth 64 përqind e grave që shërbejnë në kuvende komunale kanë të përfunduar një diplomë master ose më shumë, me pjesën e mbetur prej 36 përqind që kanë përfunduar diplomën e tyre bachelor. Nuk ka të anketuara që kanë më pak arsim të përfunduar. Ky përfaqësim është ndryshe nga popullata e përgjithshme, duke treguar kështu një arsimim më të lartë të zyrtareve të zgjedhur.

Nga të anketuarit, gjysma aktualisht po shërbejnë në mandatin e tyre të parë, një e treta po shërbejnë në mandatin e tyre të dytë, dhe pjesa tjetër janë në mandatin e tyre të tretë. Përgjigjet e grave që kanë shërbyer më shumë se një mandat në krahasim me ato që janë në mandatin e tyre të parë ndryshojnë në kuptimin e perceptimit të mundësive dhe barazisë në nivelin lokal. Anëtarët e kuvendeve komunale që kanë shërbyer para këtij mandati, tregojnë një nivel më të lartë të pakënaqësisë me mundësitë që u jepen grave në kuvendet komunale dhe në vendim-marrje.




Përfaqësimi i grave në nivelin lokal

Geographically, the respondents are spread in five selected municipalities around Kosovo. The highest response rate has been in the municipality of Prizren, whereas the lowest in Prishtina. The response rate has been around 30 percent in general for all other municipalities.

In terms of education, around 64 percent of women that are serving in municipal assemblies have completed a Master's degree or more, with the remaining 36 percent that have completed their Bachelor's degree. There are no respondents who have less education completed. This representation is unlike the general population, thus showing a higher level of education of the elected officials.

Of the respondents, half are currently serving their first mandate, a third are serving their second mandate, and the remaining are in their third mandate. The responses of women who have been serving more than one mandate compared to those in their first mandate differ in terms of perception of opportunity and equality in the local level. Members of the assembly that have served prior to this mandate show a higher level of discontent with the opportunities given to women in the local assembly and in decision making.

Figura 2: A besoni se përfaqësimi i grave në nivelin lokal është në nivelin e duhur?



Sidoqoftë, ajo që bie në sy është se ndonëse shumica pajtohet me nivelin e përfaqësimit, më shumë se një në tri gra besojnë se përfaqësimi i tyre në nivelin lokal është ose në nivel të jo të kënaqshëm ose të jo të dëshirueshëm. Megjithëse kuvendet komunale veprojnë në përputhje me kërkesat legjislative për të pasur të paktën 30 përqind të anëtarëve nga gjinia e nën-përfaqësuar, kjo mungesë e kënaqshmërisë me përfaqësimin, pasqyron numrin e ulët të grave në pozitë vendim-marrëse në nivelin lokal, veçanërisht si shefa drejtorish në komuna.

Puna aktive e grave në nivelin lokal


Duke vlerësuar nëse roli që gratë anëtare të kuvendeve komunale besojnë se ato kanë mundësi që të luajnë role kryesore në politika dhe vendime të kuvendit komunal, dy në tri gra besojnë se ato luajnë një rol kryesor, ndërsa 14 përqindëshi i mbetur, besojnë se luajnë rol kryesor deri në një farë mase, ndërsa 21 përqind besojnë se nuk është plotësisht kështu. Sidoqoftë, se a i shfrytëzojnë ato këto mundësi dhe nëse këto mundësi materializohen në politika dhe ndryshime në nivelin lokal, kjo është çështje tjetër. Sidoqoftë, qëndrimet janë shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme në mes të komunave dhe nuk tregojnë ndonjë model specifik midis partive.

Nga ana tjetër, është e rëndësishme që të vlerësohen mundësitë aktuale që u jepen grave në propozimin e politikave dhe ndryshimeve në kuvendet komunale, përtej vetë perceptimit të tyre. Nga të anketuarat 1 në 2 besojnë se u jepen të njëjtat mundësi si burrat anëtarë të kuvendit komunal, nga pjesa e mbetur, 1 në 3 besojnë se kjo është e vërtetë deri në një farë mase, dhe 1 në 6 besojnë se kjo nuk është plotësisht e saktë. Sidoqoftë, në përgjigje më specifike, ekziston ende një besim i fortë se mungesa e grave në poste vendim-marrëse në komunë, e kombinuar me mungesën e mbështetjes nga ekzekutivi, pengojnë mundësitë e grave për të propozuar politika dhe ndryshime.

Gjersa gratë që besojnë se kanë mundësi, konsiderojnë se ato janë të natyrshme për postin ku ato janë zgjedhur, të tjerat konsiderojnë se pengesat socio-kulturore, veçanërisht ato që lidhen me rolet gjinore, janë arsyeja që gratë nuk kanë mundësi të ndryshojnë politika dhe të marrin vendime në nivelin lokal.

Për më tepër, vlerësimi i përfshirjes së grave për dallim nga përfshirja e burrave, kur u pyetën nëse ato besojnë se gratë dhe burrat kanë mundësi të ngjashme për vendim-marrje në kuvendin komunal, vetëm një në tri gra pohuan se po. Nga 14 përqindëshi i mbetur, thanë se ato besojnë deri në një farë mase, ndërsa 36 përqindëshi tjetër pohuan se mundësitë e tyre nuk janë aq sa ato të burrave, me 14 përqind të grave që thanë jo në mënyrë të vendosur. Nga ato që nuk u pajtuan me këtë deklaratë, arsyet e dhëna tregojnë një pasqyrë të rëndësishme lidhur me punën e kuvendeve komunale.

Figura 3: A besoni se gratë dhe burrat i kanë mundësitë e njëjta për të propozuar dhe ndryshuar politikat?




Ndonëse gratë mbajnë rreth 30 përqind të vendeve në secilin kuvend komunal, përfaqësueset nuk besojnë se kjo kuotë u jep atyre mundësi të barabarta, duke pasur parasysh se ato përbëjnë 30 përqind të kuvendit, krahasuar me 70 përqind që përbëhet nga burrat. Për më tepër, një çështje tjetër e rëndësishme me të cilën përballen gratë anëtare të kuvendeve komunale është mungesa e grave në postet vendim-marrëse në kuadër të komunës. Nga komunat e përzgjedhura; përveç Kamenicës, e cila ka siguruar barazi gjinore në drejtoritë komunale; të gjitha të tjerat mbeten prapa sa i përket përfaqësimit të grave në postet vendim-marrëse. Kjo mungesë e grave në pozita udhëheqëse çon në pasje më pak në konsideratë të grave në kuvendet komunale. Gratë e tjera anëtare të kuvendeve komunale po ashtu pohojnë se ndonëse ato tregojnë gatishmërinë për të marrë pjesë, atyre nuk u jepet ky shans nga anëtarët e tjerë të kuvendit. Vetëm numrat si të tillë, të kombinuar me pritjet socio-kulturore sa i përket rolit të grave në jetën publike, veçanërisht në rajone më të vogla dhe më tradicionale, paraqesin një pengesë për gratë anëtare të kuvendeve komunale, si për të qenë në gjendje të propozojnë politika që marrin mbështetje, ashtu edhe të marrin pjesë vetë në vendim-marrje.

Mungesa e projekteve dhe e investimeve të ndjeshme nga aspekti gjinor

Kjo mungesë e mundësive për të ndikuar në vendime reflektohet në perceptimin e projekteve dhe të investimeve nga komuna. Të pyetura nëse ato besojnë investimet dhe projektet në komunën e tyre e kanë parasysh aspektin gjinor, shumica e të anketuarave nuk pajtohen. Pra, 43 përqind nuk pajtohen plotësisht, ndërsa 22 përqind nuk pajtohen aspak me deklaratën; 21 përqind konsiderojnë se kjo deri diku është e vërtetë, ndërsa vetëm 14 përqind pajtohen plotësisht.

Figura 4: A mendoni se investimet dhe projektet në komunën tuaj janë adekuate nga aspekti gjinor?



Arsyet kryesore për këtë janë dhënë për shkak të mungesës së buxhetimit gjinor në komunat e tyre, mungesës së integritimit gjinor në planifikim, si dhe mungesës së mbështetjes për iniciativat e grave anëtare të kuvendeve komunale. Komunitat e Kosovës nuk janë zotuar për buxhetim të ndjeshëm gjinor, i cili nga ana e tij ka ndikuar në planifikimin e buxhetit dhe zbatimin e projekteve nga komuna, pa e shqyrtuar ndikimin që kanë këto vendime buxhetore mbi gratë.

Në mënyrë të veçantë, në Prizren, mungesa e një çerdhe publike të fëmijëve është përmendur nga të gjitha të anketuarat si një shembull i mungesës së integritit gjinor në investime nga komuna. Në komunat e tjera, mungesa e buxhetimit gjinor konsiderohet si pengesë për të siguruar investime dhe projekte të ndjeshme nga aspekti gjinor. Edhe në komunat siç është Prishtina, ku komuna ka ndërmarrë hapa për të përmirësuar infrastrukturën e kujdesit ndaj fëmijëve, gratë anëtare të kuvendit komunal ende konsiderojnë se ka punë për të bërë në fusha të tjera. Në Kamenicë, ndonëse fakti që gratë përbëjnë 50 përqind të drejtuesve të drejtorive është parë në mënyrë të përbashkët si një hap i konsiderueshëm përpara, gratë anëtare të kuvendit komunal ende konsiderojnë se kuvendi komunal aktual dhe qeveria komunale nuk kanë ndërmarrë asnjë hap drejt përfshirjes së perspektivës gjinore në projekte ose në buxhetimin e komunës.


Pengesat dhe sfidat për gratë anëtare të kuvendeve komunale

Këto çështje, edhe pse të dukshme në punën e grave anëtare të kuvendeve komunale, nuk janë pengesat e vetme me të cilat ato ballafaqohen. Për të vlerësuar pengesat kryesore, të anketuarave iu kërkua t'i rendisin sfidat e tyre më të mëdha gjatë këtij mandati si anëtare të kuvendeve komunale. Ndonëse ka anëtare që kanë deklaruar se nuk kanë hasur në pengesa, shumica sish kanë deklaruar një ose më shumë çështje si pengesa. Çështjet sillen nga ato që lidhen me mungesën e mundësive për të avokuar për politikën dhe për t'i ndryshuar ato, për shkak të perceptimit të mungesës së respektit ndaj tyre si gra anëtare të kuvendit komunal; për çështje që kanë të bëjnë me mungesën e një linje të dedikuar të buxhetit për fuqizimin e grave anëtare të kuvendeve komunale.

Konkretisht, në Kamenicë, gratë anëtare të kuvendit komunal konsiderojnë se mungesa e transparencës dhe e llogaridhënies nga zyra e kryetarit të komunës; ndërhyrja e kryetarit në të gjitha vendim-marrjet; dhe mungesa e përkushtimit të kryesuesit të kuvendit komunal për të pasur një kuvend që funksionon mirë.




Figura 5: Tri pengesat kryesore të identifikuara në komunën e Kamenicës




Nga ana tjetër, gratë anëtare të kuvendit komunal në Mitrovicë konsiderojnë se mungesa e një buxheti të veçantë për aktivitete për gratë anëtare të kuvendit; mungesa e funksionalitetit të komiteteve; dhe fakti që opozita nuk është e angazhuar në kërkimin e transparencës dhe llogaridhënies nga qeveria komunale shihen si pengesat kryesore.

Figura 6: Tri pengesat kryesore të identifikuara në komunën e Mitrovicës




Në Prishtinë, gratë anëtare të kuvendit komunal konsiderojnë se mungesa e gatishmërisë për të diskutuar për politikat publike komunale në kuvend; mosarritja e komunës që të përfshijë projektet e propozuara në buxhetin komunal; dhe mungesa e gatishmërisë së kuvendit komunal për të marrë parasysh propozimet e bëra nga të anketuarat shihen si pengesat kryesore.

Figura 7: Tri pengesat kryesore të identifikuara në komunën e Prishtinës




Në Prizren, përveç mungesës së aktiviteteve dhe funksionalitetit të Zyrës për Barazi Gjinore; mungesa e gatishmërisë për të marrë parasysh propozimet e paraqitura nga të anketuarat dhe mungesa e gatishmërisë së zyrës së kryetarit të komunës për të bashkëpunuar me anëtarët e kuvendit komunal nga partitë opozitare janë pengesat kryesore të identifikuara nga gratë anëtare të kuvendit komunal.

Figura 8: Tri pengesat kryesore të identifikuara në komunën e Prizrenit



Në fund, në Istog, gratë anëtare të kuvendit komunal pengesën kryesore me të cilën ato përballen e shohin si personale, kjo është mungesa e mbështetjes nga familjet e tyre, e kombinuar kjo me obligimet e kujdesit që ato kanë në shtëpi; pengesa e dytë është e ngjashme me komunat e tjera, dhe kjo është mungesa e linjave buxhetore të dedikuara për aktivitetet e grave anëtare të kuvendit komunal; pengesa e tretë më e zakonshme në komunën e Istogut është mungesa e mbështetjes nga partia.

Figura 9: Tri pengesat kryesore të identifikuara në komunën e Istogut




Për më tepër, mungesa e transparencës në vendim-marrje, veçanërisht nga zyra e kryetarit, paraqet një çështje që është parashtruar nga shumë gra anëtare të kuvendit komunal. Këto çështje paraqesin potencial për përmirësim përmes fuqizimit të grave anëtare të kuvendit komunal, veçanërisht në aftësitë e tyre për të propozuar dhe shtyrë përpara politika dhe ndryshime.

Ndërtimi i kapaciteteve dhe fushat për përmirësim

Për të vlerësuar se në cilat fusha gratë anëtare të kuvendeve komunale konsiderojnë se mund të përfitojnë më shumë nga trajnimi, së pari u pyetën që të shohin nëse ndonjë ngritje të kapaciteteve dhe mbështetje e tillë u ofrohet atyre përmes partisë së tyre. Të gjitha të anketuarat pohuan se partitë e tyre i mbështesin ato, të paktën deri në një farë mase, ku 57 përqind e tyre deklaruan se partia e tyre u ofron atyre mbështetje të mjaftueshme, dhe pjesa tjetër (kjo është 43 përqind) deklaruan se mbështetja e partisë së tyre është mjaft e mirë. Sidoqoftë, mbështetja jo gjithmonë shndërrohet në trajnime dhe mbështetje për ndërtimin e kapaciteteve. Ndërsa 55 përqind e të anketuarave thanë se partia e tyre ofron një lloj trajnimi dhe ngritje të kapaciteteve për gratë anëtare të partisë, gati gjysma e mbetur e të anketuarave shprehën të kundërtën. Sidoqoftë, edhe anëtarët e së njëjtës parti kanë dhënë përgjigje të ndryshme në këtë pyetje, që jep një indikacion se mbase partitë ofrojnë skema të ndryshme të ngritjes së kapaciteteve në komuna të ndryshme.

Përtej trajnimeve të ofruara nga partitë e tyre, gratë anëtare të kuvendeve komunale u pyetën se në cilat fusha do të ishin më të interesuara të merrnin trajnime. Ndonëse temat e trajnimit të propozuara janë të një game të gjerë, në këtë raport paraqiten përgjigjet që bazohen në grupe tematike, të cilat u hartuan bazuar në nevojat specifike të deklaruara nga të anketuarat. Në kuadër të këtyre grupeve tematike, ka trajnime specifike që janë propozuar, megjithatë, ato tema të propozuara përmbajnë vetëm një pjesë të trajnimeve të përgjithshme nga të cilat mund të përfitojnë gratë anëtare të kuvendeve lokale.

Figura 10: Po të kishit mundësi të trajnoheshit në fusha të caktuara, çfarë trajnimi dhe cilat fusha do t'i preferonit?



Temat më të përhapura tematike në të cilat të intervistuarat do të preferonin të trajnoheshin janë fuqizimi ekonomik i grave, barazia gjinore, roli i qeverisjes lokale dhe kuvendi komunal, dhe trajnimet e përgjithshme. Ndonëse dy të fundit janë fushat ku trajnimet janë më të dobishme nëse do të ofroheshin në fillim të mandatit, temat që lidhen me fuqizimin ekonomik të grave dhe barazinë gjinore ofrohen në çdo kohë gjatë mandatit dhe do të mund të ndihmonin përtej nevojave të menjëhershme të kuvendit komunal. Në kuadër të këtyre fushave tematike, temat specifike të trajnimit të sugjeruara nga të anketuarat janë si më poshtë:

Tabela 1: Po të kishit mundësi të trajnoheshit në fusha të caktuara, çfarë trajnimi dhe cilat fusha do t'i preferonit?

Fuqizimi ekonomik i grave	Barazia gjinore	Qeverisja lokale	Trajnime të përgjithshme
Buxhetim që ka parasysh nevojat gjinore	Trashëgimia dhe të drejtat pronësore	Analiza e politikave publike	Avokim
Punësim i grave	Respektimi i barazisë gjinore	Rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të kuvendit komunal	Të folurit publik
Identifikimi i rolit dhe i potencialit në sektorë të ndryshëm ekonomikë	Dhuna në familje	Identifikimi i iniciativave për t'i përbushur nevojat e qytetarëve	Edukim në media
Zhvillimi dhe mënyrat e përkrahjes së bizneseve të vogla në pronësi të grave	Fuqizimi i grave në politikë	Çështje të mirëqenies sociale dhe roli i qeverisjes lokale në mirëqenien sociale	Media sociale
Ekonomi dhe financa gjinore		Planifikim dhe menaxhim i buxhetit	Vendim-marrje
		Menaxhimi i qeverisë lokale	Trajnime për lidhshmëri
		Fusha të ndryshme që lidhen dretpërdrejt me punën e drejtorive, sidomos në planifikim	Trajnim për çështje të rinjve

Protokoll


Sidoqoftë, këto fusha tematike nuk janë domosdo fushat në të cilat të anketuarat konsiderojnë se përfitojnë më shumë nga trajnimi, jo vetëm ato, por edhe për sa i përket nevojave të grupeve të përgjithshme të grave brenda kuvendit komunal. Megjithëse fushat tematike ku janë përqendruar të intervistuarat janë të ngjashme në të gjitha komunat, për të pasur një përmbledhje më të mirë të asaj që i nevojitet çdo komune, tabela më poshtë paraqet një matricë ku paraqiten trajnimet specifike siç janë identifikuar nga gratë anëtare të kuvendit komunal së secilës komunë.

Tabela 2: Matrica e nevojave për trajnim specifik siç është vlerësuar nga gratë anëtare të kuvendeve komunale në të gjitha komunat

	Istog	Kamenicë	Mitrovicë	Prishtinë	Prizren
Fuqizimi ekonomik i grave	Ekonomi dhe financa gjinore <hr/> Punësimi i grave	Identifikimi i rolit dhe i potencialit të grave në sektorë të ndryshëm ekonomik	Buxhetim që ka parasysh nevojat gjinore	Buxhetim që ka parasysh nevojat gjinore <hr/> Zhvillimi dhe mënyrat e përkrahjes së bizneseve të vogla në pronësi të grave <hr/> Analiza gjinore e politikave publike	Fuqizimi ekonomik i grave
Barazia gjinore	Trashëgimia dhe të drejtat pronësore <hr/> Respektimi i barazisë gjinore <hr/> Dhuna në familje		Respektimi i barazisë gjinore		Fuqizimi i grave në politikë
Qeverisja lokale	Planifikim dhe menaxhim i buxhetit		Fusha të ndryshme që lidhen drejtpërdrejt me punën e drejtorive, sidomos në planifikim	Çështje të mirëqenies sociale dhe roli i qeverisjes lokale në mirëqenien sociale	Rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të kuvendit komunal <hr/> Iniciativë e duhura për t'i përbushur kërkesat e qytetarëve <hr/> Menaxhimi i qeverisë lokale
Trajnime të përgjithshme	Trajnime për lidership	Të folurit publik <hr/> Protokoll	Media sociale		Avokim <hr/> Edukim në media <hr/> Tranime për lidership Trajnim për çështje të të rinjve <hr/> Protokoll


Numri më i madh i të anketuarave konsideron se është më e domosdoshme që ato dhe anëtarët e tjerë të kuvendeve komunale të marrin trajnime dhe ngritje të kapaciteteve në barazinë gjinore. Nën-temat që lidhen me këtë fushë tematike përfshijnë vendim-marrjen dhe avokimin për çështje që prekin gratë më shumë se çdo grup tjetër, si dhe ngritja e kapaciteteve për të përmirësuar rregulloren dhe rolin e grave në kuvendin komunal. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor dhe analiza gjinore e politikave publike konsiderohet si tema e dytë më e rëndësishme në të cilën duhet të ketë trajnim, duke pasur parasysh lidhjet e kësaj teme me propozime të politikave dhe të legjislacionit, jo vetëm gratë anëtare të kuvendeve komunale në këto komuna, por edhe burrat në kuvendet komunale, ku edhe anëtarët e zyrës së kryetarit të komunës do të përfitonin nga një trajnim i tillë. Nga ana tjetër, trajnimet për qeverisjen lokale mbeten një temë e rëndësishme, duke treguar se ka nevojë për një koordinim më të mirë ndërmjet komunës, kuvendit komunal dhe anëtarëve të kuvendit komunal, për rolet dhe detyrat e anëtarëve, dhe ndikimin e tyre në qeverisjen lokale.

Figura 11: Për cilat aspekte keni më së shumti nevojë për trajnim ju dhe koleget tuaja të kuvendit?



Përveç trajnimeve të drejtpërdrejta dhe mundësive për ndërtimin e kapaciteteve, grave anëtare të kuvendeve komunale u është kërkuar t'i rendisin mënyrat në të cilat institucionet e Kosovës, si në nivelin lokal, ashtu edhe në atë qendror, mund të ndihmojnë në përmirësimin e fuqizimit të grave. Aspekti kryesor në të cilin gratë anëtare të kuvendeve komunale konsiderojnë se institucionet mund të ndihmojnë është që të sigurohet zbatimi i Ligjit për Barazi Gjinore. Pas kësaj, aspekt tjetër i rëndësishëm që ishte një temë e përsëritur në mesin e të anketuarave ishte rëndësia e kryerjes së analizave gjinore të projekteve, si të projekteve të propozuara, ashtu edhe atyre që janë miratuar për t'u zbatuar. Për më tepër, niveli më i lartë i bashkëpunimit me institucionet, përmes seminareve dhe takimeve tematike, si dhe planifikimit më të mirë të buxhetit për të parashikuar fuqizimin e grave, janë gjithashtu mënyra në të cilat institucionet mund të përmirësojnë fuqizimin e grave në nivelin komunal.

Figura 12: Cilat janë mënyrat në të cilat institucionet (kuvendi komunal dhe qeveria qendrore) mund ta përmirësojnë fuqizimin e grave në nivelin komunal?



Rezultatet e anketës tregojnë se gratë anëtare të kuvendeve komunale, në tërësinë e tyre, tregojnë nivel të lartë të të kuptuarit të pengesave me të cilat ato përballen si dhe mënyrat për t'i kapërcyer ato. Ajo që është edhe më e rëndësishme është se përmes anketës, të anketuarat kanë treguar një gatishmëri të qartë për trajnime dhe ndërtim të kapaciteteve, si dhe për përmirësim të rolit të tyre në vendim-marrje, avokim dhe propozim të politikave. Këto të dhëna shërbejnë si bazë për zhvillimin e mëtutjeshëm të moduleve të trajnimit dhe potencialit për ndërtimin e kapaciteteve dhe angazhimin e grave anëtare të kuvendeve komunale në këto komuna. Për më tepër, kjo po ashtu mund të kërkojë shtysë për zgjerim të ndërhyrjes, për të siguruar që më shumë gra që zgjidhen nëpër kuvendet komunale t'u nënshtrohen trajnimeve dhe të jenë të përgatitura për rolet e tyre.

Përfundimet dhe rekomandimet

Angazhimi aktiv i grave në qeverisjen lokale mbetet sfidë. Gratë anëtare të kuvendeve komunale ballafaqohen me sfida dhe pengesa të shumta në përmbushjen e detyrave të tyre, si për shkak të klimës politike, mungesës së mbështetjes së partisë, por edhe për shkak të pritjeve socio-kulturore për rolet e tyre familjare. Me gjithë pengesat, më shumë se një e treta e grave të anketuara konsiderojnë se përfaqësimi i grave në nivelin lokal nuk është në nivelin e kënaqshëm. Kjo lidhet si me besimin se kuota prej 30 përqind është e ulët, por edhe kryesisht për shkak të mungesës së grave në postet vendim-marrëse brenda komunave. Përfundimet kryesore për këtë raport janë si më poshtë:

- 1** Ndonëse shumica e grave pajtohen që niveli i përfaqësimit të grave në komunën e tyre është i kënaqshëm, ende më shumë se 30 përqind e grave besojnë se përfaqësimi i tyre në nivelin lokal është ose në nivel të jo të kënaqshëm ose të jo të dëshirueshëm.
- 2** Kur u pyetën nëse besojnë se gratë dhe burrat kanë mundësi të ngjashme për vendim-marrje në kuvendin komunal, vetëm një në tri gra pohoi se kanë.
- 3** Rreth 66 përqind e grave besojnë se investimet dhe projektet në komunën e tyre nuk përfshijnë aspektin gjinor në to, qoftë plotësisht ose jo në nivel të kënaqshëm.
- 4** Gratë anëtare të kuvendit komunal në Prizren mungesën e një çerdhe publike e konsiderojnë si shembull të mungesës së integritimit gjinor në investime nga komuna.
- 5** Gjatë vlerësimit të pengesave me të cilat ato ballafaqohen, gratë anëtare të kuvendeve komunale, identifikuan çështje që sillen nga ato që lidhen me mungesën e mundësive për të avokuar dhe ndryshuar politikat, për shkak të perceptimit se ka mungesë të respektit ndaj tyre si gra anëtare të kuvendit komunal; për çështje që lidhen me mungesën e një linje të caktuar buxhetore për fuqizimin e grave anëtare të kuvendit komunal, për çështje që lidhen me mungesën e kohës së tyre për shkak të obligimeve familjare.

6 Sidoqoftë, shumica e grave tregojnë gatishmëri për t'u angazhuar në ndërtimin e kapaciteteve dhe në trajnime, megjithëse mundësi të tilla u jepen vetëm rreth gjysmës së tyre nga partitë e tyre.

7 Në vlerësimin e fushave kryesore të interesimit të tyre për trajnim, temat më mbizotëruese tematike për të cilat të intervistuarat do të preferonin të trajnohen janë fuqizimi ekonomik i grave, barazia gjinore, roli i qeverisjes lokale dhe kuvendi komunal, si dhe trajnimet e përgjithshme.

8 Nga ana tjetër, aspekti kryesor në të cilin gratë anëtare të kuvendeve komunale konsiderojnë se institucionet mund të ndihmojnë është duke siguruar që Ligji për Barazi Gjinore është duke u zbatuar.

Për t'i kapërcyer këto pengesa, gratë anëtare të kuvendeve komunale kanë identifikuar trajnime specifike dhe mundësi të ngritjes së kapaciteteve që mund të ndiqen.

Komunat, kuvendet lokale, si dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare duhet të ofrojnë trajnime në module të veçanta siç janë identifikuar nga ky raport. Katër fushat kryesore tematike, për trajnime përfshijnë: fuqizimin ekonomik të grave, barazinë gjinore, rolin e qeverisjes lokale dhe kuvendin komunal, si dhe trajnime të përgjithshme. Kërkesat specifike të trajnimit ndryshojnë nga njëra komunë në tjetrën, ndërsa modulet specifike të propozuara janë dhënë në matricën e trajnimit në raport.

Të gjitha komunat duhet të hartojnë një skemë trajnimi për të siguruar trajnime për anëtarët e kuvendeve të tyre komunale, veçanërisht trajnime në vendim-marrje lokale dhe në politika. Këto trajnime, edhe pse janë thelbësore për anëtarët e rinj/të reja të kuvendeve komunale, duhet të jenë të hapura edhe për anëtarët që kanë shërbyer në mandatet paraprake, duke pasur parasysh që përmes këtij hulumtimi është identifikuar se anëtarët e kuvendeve komunale kanë nevojë për trajnime në hartimin e politikave lokale, menaxhim, si dhe zhvillim të iniciativave.

Për më tepër, grave anëtare të kuvendeve komunale duhet t'u ofrohen mundësi që t'u nënshtrohen trajnimeve, si dhe mekanizma të tjerë për ndërtimin e kapaciteteve, veçanërisht në përmirësimin e aftësive dhe njohurive të fuqizimit ekonomik dhe politik të grave, si dhe në luftimin e pabarazisë gjinore. Zhvillimi i propozimeve të politikave dhe i projekteve në nivelin lokal që integrimi i aspektit gjinor është identifikuar si një nga fushat kryesore ku gratë anëtare të kuvendeve komunale janë të interesuara të zhvillojnë aftësi të mëtejshme. Për më tepër, buxhetimi dhe hartimi i projekteve me ndjeshmëri gjinore është me rëndësi, jo vetëm për gratë anëtare të kuvendeve komunale, por mund të jetë i dobishëm për komunat në tërësi.

Modulet e përgjithshme të trajnimit, veçanërisht ato që synojnë përmirësimin e aftësive të avokimit, komunikim më të mirë dhe edukim në fushën e mediave, si dhe në përdorimin e teknologjisë dhe mjeteve bashkëkohore për avokim, gjithashtu mund të japin rezultate të drejtpërdrejta në ndihmën e grave anëtare të kuvendeve komunale për të përmirësuar pjesëmarrjen e tyre aktive, si dhe që të rrisin potencialin për shqyrtimin e politikave të propozuara nga komunat.

Institucionet qeveritare, si ato lokale, ashtu edhe ato qendrore, duhet të përdorin mekanizma që sigurojnë zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore në nivelin lokal, veçanërisht në përmirësimin e potencialit të grave për të mbajtur poste vendim-marrëse. Ligji parasheh që të gjitha organet duhet të respektojnë një ndarje ose role të barabarta gjinore, gjë që do të përmirësonte përfaqësimin e grave në organet vendim-marrëse.

Komunat duhet të krijojnë dhe të përdorin mjete për t'i analizuar projektet dhe investimet nga perspektiva e integritit gjinor. Kjo do të sigurojë një nivel më të lartë të integritit gjinor brenda komunave.

Kuvendet komunale dhe drejtoritë komunale, kur të bëjnë përgatitjen e buxhetit komunal, duhet të sigurojnë që ka linja të caktuara buxhetore që synojnë projekte dhe investime që kanë ndikim pozitiv në fuqizimin ekonomik të grave.

Referencat

A. Cammisa, and B. Reingold, "Women in State Legislatures and State Legislative Research: Beyond Sameness and Difference," *State Politics and Policy Quarterly* Vol. 4, No.2 (2004): 181-210, <http://www.jstor.org/stable/40421515>.

Caroline Criado Perez, "Invisible Women," 2019. Abrams Press

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Nju Jork, 18 dhjetor 1979, i qasshëm në: <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/CEDAW.aspx>

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22, e qasshme në: <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

Ligji për Barazi Gjinore, 2015, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>

Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, 2015, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10924>

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, 2008, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

Plani Kombëtar i Veprimit mbi Paqen dhe Gratë, i qasshëm në: <https://www.peacewomen.org/nap-kosovo>

Shtojca 1: Pyetësori

Përtej barazisë numerike: Fuqizimi i grave anëtare të Kuvendeve të Komunave në qeverisjen lokale

Të nderuara gra anëtare të kuvendit komunal:

Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) në Prishtinë është duke realizuar një projekt hulumtues që synon të analizojë rolin e grave anëtare të kuvendeve lokale në kuvendet e tyre komunale përkatëse. Ne kërkojmë mirëkuptimin tuaj që ju të gjeni kohë për t'iu përgjigjur pyetjeve të parashtruara në këtë pyetësor. Pyetësori do të mbetet anonim për publikun, kështu që emri juaj dhe të dhënat e marra nga anketa në asnjë rast nuk do të ndahen me ose nuk do të paraqiten para publikut. Mendimi juaj nuk do t'i komunikohet askujt, dhe do të përdoret vetëm për qëllime statistikore.

1. Emri dhe mbiemri

2. Partia juaj

3. Komuna

4. Cila është shkalla më e lartë e arsimit që ju keni kryer?

Arsimi fillor

Arsimi i mesëm

Arsimi i lartë

Diplomë universitare (baçelor)

Diplomë master ose më shumë

5. A është ky mandati juaj i parë në kuvendin komunal?

Po

Jo

6.Nëse jo, në sa mandate keni shërbyer deri më tani, përfshirë edhe mandatin e aktual?

7.A mendoni se përfaqësimi i grave në nivelin komunal është adekuat?

Po

Po deri diku

Jo dhe aq

Jo

8.A mendoni që ju, si grua anëtare e kuvendit komunal, mund të luani rol kyç në politikat dhe vendimet e kuvendit komunal?

Po

Po deri diku

Jo dhe aq

Jo

9.A mendoni se gratë dhe burrat kanë të njëjtën fuqi vendim-marrëse në kuvendin komunal?

Po

Po deri diku

Jo dhe aq

Jo

10.Pse?

11.A mendoni se gratë dhe burrat i kanë të njëjtat mundësi për propozimin e politikave dhe të ndryshimeve në kuvendin komunal?

Po

Po deri diku

Jo dhe aq

Jo

12.Pse?

13.A mendoni se investimet dhe projektet në komunën tuaj janë adekuate nga aspekti gjinor?

Po

Po deri diku

Jo dhe aq

Jo

14.Pse?

15.Cilat janë sfidat kryesore më të cilat jeni ballafaquar këtë mandat?

16.A mendoni se keni përkrahje të mjaftueshme nga partia juaj?

Po

Deri diku

Jo

17.A ofron partia juaj trajnime për gratë anëtare në parti?

Po

Jo

18.Cilat janë mënyrat në të cilat kuvendi komunal mund të përmirësojë fuqizimin e grave në nivelin komunal?

19.Cilat janë mënyrat në të cilat komuna mund të përmirësojë fuqizimin e grave në nivelin komunal?

20.Cilat janë mënyrat në të cilat ligjet dhe politikat shtetërore, mund të përmirësojnë fuqizimin e grave në nivelin komunal?

Ju faleminderit për pjesëmarrje!

Shtojca 2: Lista e dokumenteve të konsultuara

- * Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- * Ligji për Barazi gjinore, 2015
- * Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, 2015
- * Ligji për Zgjedhje të Përgjithshme, 2008
- * Plani Kombëtar i Veprimit për Paqen dhe Gratë
- * Procesverbalet e mbledhjeve, Komuna e Prishtinës: 2011-2019
- * Procesverbalet e mbledhjeve, Komuna e Prizrenit: 2012-2019
- * Procesverbalet e mbledhjeve, Komuna e Mitrovicës: 2012-2019
- * Procesverbalet e mbledhjeve, Komuna e Kamenicës: 2014-2019
- * Procesverbalet e mbledhjeve, Komuna e Istogut: 2014-2019

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

352.08-055.2(496.51)

Përtej barazisë numerike fuqizimi i grave anëtare të kuvendeve të komunave në qeverisje lokale / Demokraci për Zhvillim. - Prishtinë : Demokraci për Zhvillim, 2020. - 40 f. cm.

ISBN 978-9951-608-93-0

Demokraci për Zhvillim (D4D) është një institut hulumtues I themeluar në vitin 2010 me besimin se demokracia është parakusht për zhvillim. Misioni i D4D-së është të ndikojë në proceset e zhvillimit të politikave publike në mënyrë që të përshpejtojë zhvillimin socio-ekonomik të vendit, përmirësimin e qeverisjes dhe për të përforcuar kulturën demokratike në Kosovë.

Vizioni i D4D-së është të promovojë një shoqëri aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë në hapësirën publike dhe e përdor atë për përfaqësim dhe vendim-marrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e burimeve të cilat janë efçiente, të shpejta, afat-gjate dhe që sjellin zhvillim të paanshëm. Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së vizitoni faqen tonë elektronike: www.d4d-ks.org.

ISBN 978-9951-608-93-0



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

